

Të rinjtë e komunës së Ferizajit kësaj here i bashkoi tryeza e diskutimit “Youth Talk”

Më datë 18 mars duke filluar nga ora 12:00 nxënësit e shkollave të mesme të Ferizaj si dhe studentë nga Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj u mbledhën për tu njohur më shumë dhe diskutuar për proceset e vendimmarries lokale.

Në fillim të kësaj tyeze pjesëmarrësit u njoftuan me njëri tjetrin duke vazhduar për të marrë më shumë njohuri dhe shembuj rreth vendimarrjes në institucionet arismore ku ata/ato vijoje mësimit e tyre. Ajo cka ishte më e mira gjatë këtij diskutimi, ishte se nxënësit në të vërtet kanë guxim për të marrë përsipër përgjegjësi për kolegeët e tyre, duke ngritur çështje të cilat ata i preukupojnë.

Shembulli më i mirë i kësaj ishte mënyra se si nxënësit e shkollës së mesme “Kuvendi i Arbërit” kshin marr iniciativë që ne bordin drejtues të shkollës të ngrisin diskutim për mënyrën se si ata zgjedhnin Lëndët e tyre zgjedhore. Pas kërkesave të nxënësve dhe me negociimin e tyre ata kishin arritue të zgjedhin problemin e tyre, ku edhe me këtë na lënë të kuptohet se ne në të vërtet kemi rol kyq në porceset e ndryshme venidmmarrëse.

Pas asaj ne diskutum rreth proceseve venimmarrës në qeverisjen lokale të Komunës sonë.

Njëra ndër pyetje e cila u parashtur për pjesëmarrësit ishte se a keni marrë pjesë ndonjëherë në dëgjimet publike të cilat i organizon komuna për të finalizuar proceset e ndryshme vendimmarëse?

Asnjë nga të pranishmit në sallë nuk kishte qenë pjesëmarrës në ndonjë dëgjim publik në komunë, ku kishim dy arsye – “Mos informimin nga Komuna” dhe “Mos interesimi nga nana jonë”.

Ne me një shembull shumë të thjeshtë arritëm të shpjegojmë se çfarë roli kemi ne në këtë proces dhe sa i rëndësishëm është ai. Po ashtu të pranishmit në sallë patën mundësi të parashtrojnë edhe pyetje për përfaqësuesin e YIHR-së i cili ishte edhe Jurist me profesion për mënyrat se si ne mund të ngrisim zërin tonë në bazë të mënyrave ligjore.

Krejt në fund të kësaj tryeze u bë thirrje për secilin pjesëmarrës që rruga më e drejtë për tu përfshirë në procese vendimmarrëse dhe ngritur zërin tonë për çdo gjë e cila na preukupon, është shfytëzimi i të gjitha metodave ligjore.

“Ky editorial është mundësuar me mbështetjen e YIHR KS dhe financuar nga Departamenti i Shtetit Amerikan (INL). Përmbajtja e këtij editoriali është përgjegjësi e plotë e Iniciativës për Progres (INPO) dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e INL apo YIHR KS”